



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.119/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.03.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Dajti Park 2007” dhe “Dion-AI” shpk në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-82111-12-14-2020 me objekt Loti III “*Blerje bukë thekre dhe integrale*”, me fond limit 14 918 127 (katërmëdhjetë milionë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Eraldo-2013” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

**Ankimues:**

“Kadra” shpk  
Rruga “Nënë Tereza”, Laknas, Tiranë

“Eraldo-2013” shpk  
Rruga “Ali Shefqeti”, banesë private nr.17 Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve,  
Bashkia Tiranë  
Rr. “Barrikadave”

**Subjekt i Interesuar:** “Dajti Park 2007” shpk  
Rruga “Bardhok Biba”, Pallati TREMA, Hyrja C,  
Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”,  
i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të  
Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e  
Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi  
i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë  
12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për  
Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të  
Prokurimit Publik, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të  
Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë  
5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave  
Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së  
Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë  
gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 14.12.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur, me nr.REF-82111-12-14-2020 me objekt “Blerje bukë thekre dhe integrale”, me fond limit 14 918 127 (katërbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë

II.2. Në datën 18.01.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 29.01.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Eraldo 2013	9,018,480	I skualifikuar
- Dajti Park 2007	9,222,000	I kualifikuar
- Dion –Al	10,048,800	I kualifikuar
- Kadra	13,992,000	I kualifikuar

II.4. Në datën 04.02.2021 operatori ekonomik “Kadra” shpk ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- *Operatori ekonomik Dajti Park 2007 shpk nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.1. për kapacitetin teknik sipas të cilit: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve te fundit, nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlere jo më të vogël se 40 % e vlerës se përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.*

*Në dijeninë tonë ky OE nuk e plotëson këtë kriter pasi në këtë procedurë ai nuk ka paraqitur kontrata të realizuara me subjekte shtetërore ku të jenë të specifikuar bukë thekre dhe integrale. Gjithashtu edhe faturat e TVSH që ky OE mund të ketë paraqitur nuk kanë objektin e prokurimit bukë thekre dhe integrale. Pra nga hulumtimi ynë Dajti Park 2007 shpk nuk ka përvojë në furnizime të ngjashme të cilat të përmbajnë objektin e prokurimit të përcaktuar në këtë procedurë nga autoriteti kontraktor. Nisur nga specifika e autoritetit kontraktor dhe faktit që objekti i kësaj procedure është blerje bukë thekre dhe integrale e cila do të konsumohet nga fëmijë të vegjël që frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet e Tiranës, duhet patjetër që operatori ekonomik të ketë përvojë të mëparshme në prodhimin dhe furnizimin me artikullin bukë thekre dhe integrale pasi Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë është e një rëndësie të veçantë. Kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktor të verifikojë dhe njëherë dokumentacionin e operatorit ekonomik Dajti Park 2007 shpk për plotësimin e këtij kriteri bazuar në kërkesat e përcaktuara në këtë objekt prokurimi.*

- *Operatori ekonomik Dajti Park 2007 shpk nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.2 për kapacitetin teknik sipas të cilit : Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Certifikatë ISO 9001-2015, ISO 14001:2015, ISO 22000: 2018 ose ekuivalente me to, të vlefshme.*

*Nisur nga kriteri i sipërcituar në dijeninë tonë operatori ekonomik Dajti Park 2007 shpk nuk disponon ISO 9001:2015 dhe ISO 22000:2018 në të cilat të jetë e specifikuar objekti i prokurimit, por ISOT që ka paraqitur në këtë procedurë janë për një objekt të ndryshëm nga objekti i Lotit III Blerje bukë thekre dhe integrale, pra më specifikisht në këto ISO nuk është i paraqitur i specifikuar objekti prodhim tregtim buke dhe nënprodukte brumi kjo e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit. Kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktor të verifikojë dhe njëherë dokumentacionin e operatorit ekonomik Dajti Park 2007 shpk për plotësimin e këtij kriteri bazuar në kërkesat e përcaktuara në këtë objekt prokurimi.*

- *Operatori ekonomik Dajti Park 2007 shpk nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.6 kapaciteti teknik sipas të cilit : Operatori Ekonomik duhet të ketë, “Furrë buke” në pronësi ose në përdorim ose me marrëveshje bashkëpunimi/furnizimi sipas kontratës noteriale (ku periudha e bashkëpunimit, të përfshijë afatet e parashikuara për zbatimin e kontratave të MK), për të garantuar zbatimin e kontratës me kapacitet total 3000 buke në ditë. Furra duhet të ketë të gjitha ambientet e përshtatshme për ruajtjen, magazinimin dhe prodhimin e bukës.*

*Për çdo rast, OE duhet të paraqesë një vetëdeklarim ku të deklarojë se për Furrën e Bukës disponohet:*

- *Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)*  
*Të kategorisë II.1.A.1 : Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve për njerëz*
- *Leje Higjeno-Sanitare.*
- *Certifikata dezinfektimi për ambientin “Furrë Buke”, për vitin 2020.*

*Në dokumentacionin e paraqitur për ambientin Furrë Buke Dajti Park 2007 shpk ka paraqitur certifikatën e pronësisë së një objekti ndërtimor kompleks me nr. pasurie 18/89 lëshuar nga ZRPP Tiranë. Në këtë dokumentacion nuk ka përfshirë një akt noterial që të vërtetojë sipërfaqen që shërben si furrë buke dhe ambient të përshtatshëm për ruajtjen , magazinimin dhe prodhimin e bukës. Operatori nuk ka paraqitur një akt noterial që të vërtetojë që furra e bukës të ketë një kapacitet total 3000 bukë në ditë për të garantuar zbatimin e kontratës. Gjithashtu në dijeninë tonë operatori ekonomik Dajti Park 2007 shpk ka paraqitur një certifikatë dezinfektimi e cila nuk është e specifikuar për ambientin furrë bukë siç kërkohet në kriterin e mësipërm. Kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktor të verifikojë dhe njëherë dokumentacionin e operatorit ekonomik Dajti Park 2007 shpk për plotësimin e këtij kriteri bazuar në kërkesat e përcaktuara në këtë objekt prokurimi.*

- *Operatori ekonomik Dajti Park 2007 shpk nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.9 për kapacitetin teknik sipas të cilit : Operatori ekonomik duhet të paraqesë një moster sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor për secilin artikull të kërkuar. Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë DPÇK me adresë Rr. e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tiranë. Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë e cila të përmbajë elementet: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik. Ditën e paraqitjes së mostrave, operatori ekonomik duhet të paraqesë për secilin nga artikujt e lotit së bashku me mostrat edhe dëshmi të rezultateve të testimeve zyrtare, origjinale ose kopje të noterizuar (të leshuara nga institucione të autorizuar dhe të akredituara të kontrollit ose referencës, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike).*

*Në dijeninë tonë operatori ekonomik Dajti Park 2007 shpk ka paraqitur për objektin e prokurimit bukë thekre dhe integrale dëshmi të lëshuara nga një laborator privat më konkretisht nga laborator privat Noval Laboratory shpk. Nga verifikimi në faqen zyrtare të DPA Noval Laboratory shpk ka certifikatën me numër regjistrimi LT084. Nga shqyrtimi i listës së analizave për të cilat ky laborator ka të vlefshëm akreditimin ne konstatojmë që ky laborator nuk është i akredituar për kryerjen e të gjitha analizave fiziko kimike (lagështi, porozitet, aciditet, kripë) sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor. Pas verifikimit në faqen zyrtare të DPA ku konstatojmë që Noval Laboratory shpk nuk ishte i akredituar për kryerjen e analizave fiziko kimike për objektin e prokurimit bukë thekre dhe integrale. Ne ju drejtuam DPA-së me shkresën zyrtare nr.70 datë 28.12.2020 për të marrë një përgjigje zyrtare nga ky institucion për laboratorët privatë të akredituar për kryerjen e analizave fiziko kimike të bukës (lagështi, aciditet, porozitet, kripë). DPA na u përgjigj me shkresën zyrtare me nr. 30 prot datë 11.01.2021 sipas së cilës thuhet shprehimisht se ky institucion nuk ka akredituar asnjë laborator testues për analizën e bukës (analizat fiziko kimike) Kopje e përgjigjes bashkëngjitur ankesës. Nisur nga sa më sipër analizat e paraqitura nga*

*Dajti Park 2007 shpk janë të pavlefshme pasi janë lëshuar nga një institucion i paautorizuar dhe i paakredituar. Referencë Vendimi KPP 801/2019 datë 23.12.2019. Kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktor të verifikojë dhe njëherë dokumentacionin e operatorit ekonomik Dajti Park 2007 shpk për plotësimin e këtij kriteri bazuar në kërkesat e përcaktuara në këtë objekt prokurimi.*

*2. Operatori Dion- Al shpk nuk plotëson kërkesën sipas pikës 1 kriteret e përgjithshme të kualifikimit pika a: Ofertuesi duhet të deklarojë se: a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.*

*Gjatë hulumtimit tonë vëmë re që në fushën e veprimtarisë operatori Dion-Al shpk nuk e ka të pasqyruar në fushën e veprimtarisë objektin e kësaj procedure më konkretisht nuk e ka të pasqyruar prodhim, tregëtim të bukës dhe të prodhimeve të tjera të brumrave , pra nuk është e cilësuar në fushën e aktivitetit objekti i prokurimit i vendosur nga autoriteti kontraktor. Kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktor të verifikojë dhe njëherë dokumentacionin e operatorit ekonomik Dion -Al shpk për plotësimin e këtij kriteri bazuar në kërkesat e përcaktuara në këtë objekt prokurimi.*

- *Operatori ekonomik Dion -Al shpk nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.1. për kapacitetin teknik sipas të cilit: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjate tre viteve të fundit.*

*Në dijeninë tonë ky OE ka paraqitur fatura tatimore shitjeje. Nga hulumtimi jonë dhe nisur nga fusha e veprimtarisë së operatorit ekonomik shërbim catering , faturat tatimore të paraqitura nuk evidentojnë përshkrimin e mallit sipas objektit të prokurimit bukë thekre dhe integrale . Pra operatori ekonomik Dion –Al shpk nuk ka përvojë në furnizime të ngjashme të cilat të përmbajnë objektin e prokurimit. Kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktor të verifikojë dhe njëherë dokumentacionin e operatorit ekonomik Dion -Al shpk për plotësimin e këtij kriteri bazuar në kërkesat e përcaktuara në këtë objekt prokurimi.*

- *Operatori ekonomik Dion-Al shpk nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.2 për kapacitetin teknik sipas të cilit : Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Certifikatë ISO 9001-2015, ISO 14001:2015, ISO 22000: 2018 ose ekuivalente me to, të vlefshme.*

*Nisur nga kriteri i sipërcituar në dijeninë tonë operatori ekonomik Dion-Al shpk nuk disponon ISO 9001:2015 dhe ISO 22000:2018 në të cilat të jetë i specifikuar objekti i prokurimit, por ISOT që ka paraqitur në këtë procedurë kanë objekt shërbim catering dhe të gjitha shërbimet e tjera të lidhura ngushtës me shërbimin catering. Pra në ISOT e paraqitura nga operatori ekonomik Dion-Al shpk nuk është i paraqitur i specifikuar objekti prodhim tregëtim buke dhe nënprodukte brumi kjo e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit. Kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktor të verifikojë dhe njëherë*

*dokumentacionin e operatorit ekonomik Dion-Al shpk për plotësimin e këtij kriteri bazuar në kërkesat e përcaktuara në këtë objekt prokurimi.*

- *Operatori ekonomik Dion -Al shpk nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.5 kapaciteti teknik sipas të cilit: Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë: Licensë me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të prokurimit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtme:  
Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.  
Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.  
Në dijeninë tonë operatori ekonomik Dion –Al shpk nuk disponon Licensë II.1.A.1 me emërtim përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të prokurimit. Gjatë kërimit në faqen zyrtare të QKB vëmë re se licensat që ky operator disponon janë për shërbim katering dhe në asnjërin prej tyre nuk ka të përshkruar veprimtarinë sipas objektit të prokurimit , prodhim dhe tregtim të bukës dhe nënprodukteve të brumërave. Kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktor të verifikojë dhe njëherë dokumentacionin e operatorit ekonomik Dion-Al shpk për plotësimin e këtij kriteri bazuar në kërkesat e përcaktuara në këtë objekt prokurimi.*
  
- *Operatori ekonomik Dion –Al shpk nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.6 kapaciteti teknik sipas të cilit : Operatori Ekonomik duhet të ketë, “Furrë buke” në pronësi ose në përdorim ose me marrëveshje bashkëpunimi/furnizimi sipas kontratës noteriale (ku periudha e bashkëpunimit, të përfshijë afatet e parashikuara për zbatimin e kontratave të MK), për të garantuar zbatimin e kontratës me kapacitet total 3000 bukë në ditë. Furra duhet të ketë të gjitha ambientet e përshtatshme për ruajtjen, magazinimin dhe prodhimin e bukës.  
Në dijeninë tonë operatori ekonomik Dion Al shpk nuk ka paraqitur një akt noterial që të vërtetojë që furra e bukës të ketë një kapacitet total 3000 bukë në ditë për të garantuar zbatimin e kontratës.Gjithashtu në dijeninë tonë operatori ekonomik Dion Al shpk nuk ka paraqitur certifikatë dezinfektimi e cila të jetë e specifikuar për furrë buke siç kërkohet në kriterin e mësipërm. Kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktor të verifikojë dhe njëherë dokumentacionin e operatorit ekonomik Dion -Al shpk për plotësimin e këtij kriteri bazuar në kërkesat e përcaktuara në këtë objekt prokurimi.*
  
- *Operatori ekonomik Dion-Al shpk nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.9 për kapacitetin teknik sipas të cilit : Operatori ekonomik duhet të paraqesë një moster sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor për secilin artikull të kërkuar.  
Mostrat do paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë DPÇK me adresë Rr. e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tiranë. Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë e cila të përmbajë elementet: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit,*

*emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik. Ditën e paraqitjes së mostrave, operatori ekonomik duhet të paraqesë për secilin nga artikujt e lotit së bashku me mostrat edhe dëshmi të rezultateve të testimeve zyrtare, origjinale ose kopje të noterizuar (të leshuara nga institucione të autorizuar dhe të akredituara të kontrollit ose referencës, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike).*

*Sipas shtojcës 10 specifikimet teknike janë përcaktuar specifikimet teknike dhe treguesit që duhet të përmbajë dëshmia e paraqitur pranë autoritetit. Në dijeninë tonë operatori ekonomik Dion –Al shpk ka paraqitur raport analizë e cila nuk përmban të gjithë treguesit e kërkuar në shtojcën 10 specifikimet teknike. Më konkretisht në dijeninë tonë operatori ekonomik ka paraqitur një raport analizë për bukë thekre ku mungojnë më saktësisht këto tregues:*

- Pamja
- Ngjyra
- Konsistenca
- Era dhe shija
- Lëndët e huaja

*Dhe gjithashtu ka paraqitur një raport analizë për bukë integrale ku mungojnë më saktësisht këto tregues:*

- Pamja
- Ngjyra
- Konsistenca
- Era dhe shija
- Lëndët e huaja.

*Kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktor të verifikojë dhe njëherë dokumentacionin e operatorit ekonomik Dion -Al shpk për plotësimin e këtij kriteri bazuar në kërkesat e përcaktuara në këtë objekt prokurimi.*

*Sa më sipër kërkojmë rivlerësimin e ofertave dhe skualifikimin e operatorit ekonomik Dajti Park 2007 shpk dhe operatorit ekonomik Dion Al shpk.*

II.5. Në datën 08.02.2021 me shkresën nr.158/4 prot operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.6. Në datën 15.02.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 29.01.2021 operatori ekonomik “Eraldo-2013” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.



- *1.1 Kriteret e Përgjithshme, shtojca 8, operatori ekonomik ka plotësuar me pasaktësi shtojcën. Sipas shtojcës së paraqitur nga operatori ekonomik “Eraldo 2013” shpk, citohet: “Unë i nënshkruari Eglantina Prenci me cilësinë e Administratorit të operatorit ekonomik Eraldo 2013 shpk, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se...”, ndërkohë që administratori i kësaj shpk rezultoi të jetë Endrit Qordja. Plotësimi i saktë i dokumentacionit është detyrim ligjor i operatorit ekonomik, pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.*

II.8. Në datën 03.02.2021 operatori ekonomik “Eraldo 2013” shpk ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- *Shtojca 8 Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme është plotësuar nga personi përgjegjës i cili merret me prokurimet publike, dhe pas plotësimit është firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqërisë Endrit Qordja. Të gjithë elementët e deklaratës janë plotësuar në rregull si të dhënat e shoqërisë ashtu edhe të dhënat e personit me të drejtë vendimmarrje të shoqërisë konkretisht administratori dhe njëherazi ortaku i vetëm i saj, të cilat i kanë shërbyer KVO-së për verifikimin e gjendjes gjyqësore si të Endrit Qordja ashtu edhe të shoqërisë Eraldo 2013 shpk. Ka ndodhur një lapsus nga ana e personit i cili ka plotësuar shtojcën dhe në vend të Endrit Qordja është venë një emër tjetër i cili nuk është administrator i kësaj shoqërie (kjo për shkak të bashkëpunimit me shoqërinë Eagle Cons shpk për Lotin 1) dhe është venë pa dashje emri i administratorit të kësaj shoqërie, lapsus i cili nuk ka penguar aspak KVO për verifikimin e figurës së administratorit dhe njëkohësisht ortakut të vetëm dhe të shoqërisë që ai përfaqëson. Përderisa kjo shtojcë përmbush qëllimin e saj është firmosur dhe vulosur nga vetë administratori i shoqërisë nuk mendojmë se ky lapsus përbën shkak për skualifikim. Ky pretendim do të qëndronte nëse kjo shtojcë nuk do të ishte paraqitur fare, e plotësuar me të dhëna të rreme, Endrit Qordja apo shoqëria Eraldo nuk do të përmbushnin qoftë edhe një nga pikat e kësaj deklarate. Lapsuset janë njerëzore dhe në rastin konkret duket që është një lapsus i paqëllimtë dhe për më tepër nuk ndryshon aspak thelbin, qëllimin dhe vërtetësinë e kësaj shtojce. Kjo shtojcë në fund të saj është firmosur nga vetë administratori i saj Endrit Qordja si dhe vulosur prej tij me vulën e shoqërisë Eraldo 2013 shpk, pra nuk është shtojcë e një operatori tjetër ekonomik, lapsusi i bërë në krye të saj nuk devijon as KVO as ju nga verifikimi i vërtetësisë së kësaj shtojce pasi të gjitha të dhënat për verifikim janë të sakta. Kërkojmë kualifikimin e shoqërisë tonë dhe rikuotimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë duke respektuar nenin 53 të LPP i ndryshuar.*

II.9. Në datën 04.02.2021 me shkresën nr.142/4 prot operatori ekonomik ankimues ka marrë dëgjimin lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.10. Në datën 11.02.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.11. Nëpërmjet shkresës nr.158/7 prot datë 23.02.2021 protokolluar me tonën me nr.248/2 prot datë 26.02.2021 dhe shkresës nr.142/7 prot datë 18.02.2021 protokolluar me tonën me nr.229/2 datë 22.02.2021 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ‘Eraldo-2013’ shpk mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “1.1 Kriteret e Përgjithshme, shtojca 8, operatori ekonomik ka plotësuar me pasaktësi shtojcën. Sipas shtojcës së paraqitur nga operatori ekonomik “Eraldo 2013” shpk, citohet: “Unë i nënshkruari Eglantina Prenci me cilësinë e Administratorit të operatorit ekonomik Eraldo 2013 shpk, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se...”, ndërkohë që administratori i kësaj shpk rezulton të jete Endrit Qordja. Plotësimi i saktë i dokumentacionit është detyrim ligjor i operatorit ekonomik, pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

#### **DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

- Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

- Emër, atësi, amësi, mbiemër, datëlindja, vendlindja, Nr. ID

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP<sup>1</sup>.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_**

**Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_**

**Vula \_\_\_\_\_**

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Eraldo-2013” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

### **DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME**

<sup>1</sup> Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë.

*Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë 18.01.2021 nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve me objekt Loti III “Blerje bukë thekre dhe integrale”, me fond limit 14 918 127 (katërbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH.*

*Unë i nënshkruari Eglantina Prenci me cilësinë e Administratorit të operatorit ekonomik Eraldo-2013 shpk deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:*

- *Operatori ekonomik Eraldo – 2013 shpk është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*
- *Operatori ekonomik Eraldo-2013 shpk nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në Nenin 45/1 të LPP.*
- *Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*
- ***Emër, atësi, amësi, mbiemër, datëlindja, vendlindja, Nr. ID***

*Endrit Qordja, Atësi: Hysni, Amësi: Sheje, Datëlindja: 06.10.1991, Vendlindja: Tiranë, ID nr.035691534, Nr.personal J11006060P*  
*\_\_\_\_\_ etj.*

*nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP<sup>2</sup>.*

- *Operatori ekonomik Eraldo-2013 shpk nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*
- *Operatori ekonomik Eraldo-2013 shpk nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*
- *Operatori ekonomik Eraldo -2013 ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

---

<sup>2</sup> Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë.

*Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.*

*Data e dorëzimit të deklaratës 18.01.2021*

*Nënshkrimi i ofertuesit Endrit Qordja*

*Vula e shoqërisë Eraldo shpk*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”*

III.1.4. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues “Eraldo -2013” shpk ka paraqitur shtojcën 8 me emërtim *“Deklaratë Mbi Përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme”*, sikundër kërkohet në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Referuar edhe parashtrimeve në ankesë të ankimuesit rezulton se ankimuesi pranon se në deklaratën e paraqitur është bërë një lapsus gjatë plotësimit të saj nga personi përgjegjës i prokurimit ku vetëm në krye të deklaratës është cituar gabim emri i administratorit, ndërsa në të gjitha seksionet e tjera deklarata dhe emri i administratorit është plotësuar në rregull.

III.1.5. Referuar sa më sipër, KPP gjykon se pretendimet e operatorit ekonomik “Eraldo-2013” shpk lidhur me lapsusin në plotësimin e deklaratës në rastin konkret janë të drejta dhe nuk çenojnë thelbin dhe përmbajtjen e deklaratës e cila nga shqyrtimi dhe verifikimi i saj përmban emrin e administratorit në të gjitha seksionet e tjera dhe vetëm në paragrafin e parë emri i tij është cituar gabim. Gjithashtu deklarata përmban në të gjitha paragrafët e saj emrin e shoqërisë “Eraldo -2013” shpk çka do të thotë se deklaratimet e cituara në të i referohen kësaj shoqërie dhe administratorit të saj. Pasaktësia e evidentuar në rastin konkret mund të konsiderohet devijim i vogël i cili nuk ndryshon formën dhe përmbajtjen e deklaratës në kuptim të nenit 53 pika 4 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.*

KPP gjykon se deklarata e sipërcituar e dorëzuar nga ankimuesi plotëson qëllimin për të cilin është vendosur shtojca 8 dhe është bërë pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit dhe lapsusi i konstatuar në të nuk mund të çbëjë përmbajtjen e saj, në të cilën në thelb flitet për operatorin Eraldo-2013 shpk dhe administratorin e saj Endrit Qordja. Akoma më tej në

seksionin ku kërkohet **Emër, atësi, amësi, mbiemër, datëlindja, vendlindja, Nr. ID, është plotësuar pikërisht për administratorin e shoqërisë Eraldo-2013 shpk** : Endrit Qordja, Atësi: Hysni, Amësi: Sheje, Datëlindja: 06.10.1991, Vendlindja: Tiranë, ID nr.035691534, Nr. personal J11006060P, çka nuk lë vend për konfuzion lidhur me personin në cilësinë e administratorit të shoqërisë. KPP gjykon se në rastin konkret nuk kemi të bejmë me mungesë fizike të dokumentacionit apo plotësimi në formë dhe përmbajtje të gabuar që nuk përmbush qëllimin për të cilin është kërkuar, por thjesht një lapsus kalemi, e për këtë arsye nuk mund të përbëjë shkak për skualifikim në kuptim të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 e ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Referuar arsyetimit sa më sipër, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Eraldo -2013” shpk në rastin konkret konsiderohet i vlefshëm për procedurën e prokurimit objekt ankimi për sa kohë që lapsusi i konstatuar në të në asnjë rast nuk mund të thuhet se ka prekur thelbin dhe përmbajtjen e deklaratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Eraldo-2013” shpk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ‘Kadra’ shpk mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Dajti Park 2007” shpk dhe “Dion-Al” shpk Komisioni vëren se,

III.2.1. Në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me plotësimin e kriterëve nga 2 operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.2.2. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 20, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.*

III.2.3. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.2.4. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/premendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.2.6. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar efiçencën e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krahasim të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrajnë pretendime a-priori duke mos identifikuar asnjë element konkret brenda kritereve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij.

Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”.

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjithë elementët proceduralë, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. Konkretisht, neni 21 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikon se: “*Informacioni i administruar, sipas nenit 12 të këtij ligji, i vihet në dispozicion çdo*

*personi të interesuar, palë në proces, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi i ofertave. Autoriteti kontraktues është i detyruar ta vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”, ndërkohë në nenin 25 të tij parashikohet se “Pa cenuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave”.*

III.2.7. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.2.8. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Eraldo-2013” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr.REF-82111-12-14-2020 me objekt Loti III “*Blerje bukë thekre dhe integrale*”, me fond limit 14 918 127 (katërbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.01.2021 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kadra” shpk për procedurën e prokurimit të sipërcituar.



3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Eraldo-2013” shpk duke e kualifikuar atë.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Eraldo-2013” shpk.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.229 Protokolli; Datë 11.02.2021**

**Nr. 248 Protokolli; Datë 15.02.2021**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**